

VENDIM
Nr.1291, datë 24.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MESUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë - letërsi;

b) në lëndët “Matematikë - fizikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë - fizikë;

c) në lëndët “Matematikë-informatikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë - informatikë;

c) në lëndët “Biologji-kimi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji- kimi;

d) në lëndën “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplome, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze;

dh) në lëndën “Gjuhë gjermane”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë gjermane.

2. Programet e studimeve master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë, bazë realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha